



Федерација на планинарски спортови во Македонија  
Federata e sporteve alpiniste në Maqedoni  
Mountaineering Sport Federation of Macedonia

11 Октомври 42, 1000, Скопје  
Република Македонија  
11.Октомври 42, 1000. Скопје  
Republika e Maqedonisë  
11 Октомври 42, 1000, Скопје  
Republic of Macedonia

+389 2 3 165 540  
<http://www.fpsm.org.mk/>  
[contact@fpsm.org.mk](mailto:contact@fpsm.org.mk)

## REKOMANDIM SHOQATAVE ALPINISTE/BUJQËSORE PËR ORGANIZIM TË AKSIONEVE ALPINE ME MASS

### Para fillimit të aksionit

1. Zgjedhja e ekipit organizues
2. Përgatitja e Thirrjes për aksion alpinë/bjeshkatar që i përfshinë informatat e domosdoshme:
  - Organizuesi
  - Objektivi (maja e malit, rajoni, ...).
  - Përshkrimi i kalesës: lloji i kalesës (e lehtë, e rrëndë, shumë e rrëndë), gjatësia, kohëzgjatja, dallimi në lartësi, burimet, vendpushimet, pjesët e rrezikshme.
  - Lista e guidave/koordinuesve dhe numrat e telefonit të tyre
  - Data, koha e nisjes / e kërthimit
  - Afati për paraqitje
3. Përgatitje fizike e duhur, veshëmbathja, pajisjet e duhura, ushqimi, uji.
4. Organizuesi duhet të bëjë thirrje shoqatave alpiniste/bjeshkatore si dhe thirrje guidave të FSAM për marrje pjesë, bashkpunim dhe ndihmë gjatë egzekutimit të aksionit alpinistik.
5. Zgjedhja e kalesës, që është e përshtatshme për motin.
6. Vendosja e GPS rutës, profilit si dhe skica e kalesës në internet faqen e shoqatës alpine/bujqësore ose në rrjetet sociale..
7. Tgjedhja e vendeve të përshtatshme për parkim të automjetit tll përbashkët (avtobusit, furgonit) si dhe automjeteve personale.
8. Lajmërim policisë, pakut nacional, shq.Makedonski Shumi, si dhe institucioneve tjera që kanë jurisdiksion në regjionin në të cilin do të zhvillohet aksioni alpin i paraparë.
9. Angazhim i personave mjekësorë (vendim i shoqatës alpine/bujqësore)
10. Shënim i kalesës dhe i pikave kyçe, kryqëzimeve, vend pushimeve si dhe vendeve të rrezikshme
11. Regjistrim i kontakt detajeve të pjesëmarrësve në aksion alpin disa ditë para aksionit
12. Kontrolli i gjendjes së automjeteve (furgonë, avtobusë): ftohjes, nxemjes, higjiëna.
13. Aktivitete tll tjera për pasurim e ngjarjes (jashtë aksionit e organizuar)
  - a. Thirrja bashkimit lokal si dhe organizatave lokale në regjionin në të cilin mbahet aksioni alpin.

## Gjatë aksionit Во текот на акцијата

- Grupi i përgatitur nga organizuesi duhet të nisët para alpinistët/bjeshkatarët edhe t'a shenjoje kalesën.
- Guida e grupit të parë duhet të jetë në kontakt me guidat e grupeve të tjera nëpërmjet radio-stacioneve, për informata për fillimin dhe rrjedhjen e aksionit.
- Grupet e pjesëmarrësve që ngjiten lartë duhet të jenë të shoqëruar nga organizuesi/guidat/koordinuesit.
- Në pikat e kontrollit, pikëpushimet, vendet e rrezikshme, kryqëzimet, organizuesi duhet të vendosë persona me detyrë që t'i udhëzojnë pjesëmarrësit në kalesën e saktë. Siç që vijnë udhëheqësit me grupet e veta, ashtu këta persona duhet të shkojnë në pikën e kontrollit që vjen në rradhë, në të cilën e zëvendësojnë kolegun i cili shkoi drejt pikës në rradhë më lartë. Ky sistem kontrolli vlen edhe gjatë zbritjes nga maja.
- Plotësim i transportit të përbashkët (autobuse dhe furgone) sipas zbritjes e pjesëmarrësve nga mali dhe evidenca e personave që largohen.

## Pas përfundimit e aksionit

- Analiza e aksionit në të cilën merr pjesë ekipi organizativ.

## VËREJTJE

Organizuesi/ guida ka të drejtë që t'i paralajmëroj/ këshillojnë pjesëmarrësit e aksionit të cilit nuk i respektojnë rregullat për lëvizjen e sigurt në mal/bjeshkë, të cilit nuk jan fizikisht të përgatitur për aksionin, të cilit nuk e posedojnë veshëmbathjen dhe pajisjet e duhura, të cilit sillen në mënyrë të papërshtatshme gjatë aksionit.

- Organizuesit dhe guidat e aksionit alpin duhet të dallohen (veshja, pajisja). Me veshjen, pajimin dhe sjelljen, ata duhet t'i jenë nxitës kryesor për lëvizjen e sigurt në mal.

## DETYRUESHËM TË INSISTOHET NË:

- Veshëmbathjet dhe pajisjet të përshtatshme me motin.
- Lëvizjen përgjatë kalesës të synuar.
- Hedhjen e mbeturinave në vendet e caktuara.
- Kohën e saktë e nisjes dhe e përfundimit të aksionit.
- Kohën e saktë e nisjes së transportit.
- Mbrojtjen e natyrës (bimëve, kafshave, higjiena)

## NUK LEJOHET:

- Përdorimi i veshëmbathjes së papërshtatshme.
- Konsumimi i alkoolit.
- Lëshimi i kalesës të paraparë për lëvizje pa dijen e organizuesve/guidave.
- Shkatërrimi i natyrës, këputja e bimëve, vrasja e kafshëve.
- Ndezja e zjarrit (përveç në rrast të shpëtimit e personave të zhdukur).